Evidencë e presioneve mbi resurset ujore: Kush i ndot ujërat në Maqedoni?

PROF. D-R BILJANA PULESKA JANUSHEVSKA
M-R DEJAN ANDONOV



Rezyme

Egzistimi i sistemit informativ për dhënien të licencave të ujit, shkalla e ndotjes të ujërave dhe përcaktimi i burimeve të ndotjes duhet të jenë bazë për Ministrinë e mjedisit jetësor dhe planifikimit hapësinor (MMJPH) gjatë udhëheqjes të një politike të qëndrueshme për ujërat. Në mungesë të evidencës të kompletuar të shfrytëzuesve dhe ndotësve të ujit nuk mund të përcaktohet niveli i ndikimit të dëmshëm, për atë arsye çdo masë drejtuese është paushale. Çdokush mund të lëshon materie të dëmshme dhe të rrezikshme pa poseduar licencë, të ndotë dhe gjatë kësaj mos tju nënshtrohet sanksioneve për veprimin kundërligjor. Sipas Entit shtetëror për statistikë, ujërat e zeza nga industria dhe minierat lishohen të papastruara direkt në truallin, kanalizimin, rrjedhat ujore, akumulacionet ose liqenet. Edhe ndërmarjet komunale publike pa trajtim i lëshojnë ujërat e zeza në rrjedhat ujore natyrore. Është e ulët përqindja e licencave të dhëna për shfrytëzim dhe lëshim në ujë. Egzistimi i evidencës të licencave ujore, regjistër i materieve të dëmshme që lëshohen në ujëra dhe katastër për burimet e tyre do tju mundëson organeve kompetente të përcjellin bartësit e licencave ujore a veprojnë në pajtim me to, ti identifikojnë subjektet të cilat në mënyrë joligjore dhe pa licencë shfrytëzojnë ose lëshojnë në ujë dhe ta sanksionojnë dhe ta ndalojnë atë praktikë joligjore të degradacionit të ujërave. Kjo do të kontribuon edhe në transparencën dhe pjesëmarjen e publikut në sjelljen e vendimeve në sferën e ujërave.

Rekomandime

- Të merren masa për implementim konsekuent të dispozitave të Ligjit për ujëra;
- Të krijohen libër ujor dhe Katastër të ndotësve të ujit dhe të sigurohet sistem për mbledhje/dorëzim të të dhënave relevante për menaxhim me ujërat;
- Të përshkruhet mënyra e krijimit dhe azhurimit të sistemit informativ për ujëra, si dhe mënyra dhe forma e mbajtjes dhe mbledhjes e të dhënave hyrëse për Katastër të ndotësve dhe të implementohen në mënyrë adekuate;
- Të përpunohet zgjidhje softuerike për mbledhje të të dhënave për ndotësit e ujërave, me të cilën do të krijohet dhe në mënyrë të kontunuar do të mirëmbahet sistemi informativ për ujëra, posaqërisht për dhënien e licencave dhe përcjelljen e tyre;
- Të mundësohet qasje në të dhënat nga sistemi deri te organet inspektuese;
- Të mundësohet qasje e lirë deri te informatatat nga sistemi për publikun, pa kërkesa dhe veprime të veçanta.



Egzistimi i informatave të sistematizuara për shfytëzuesit dhe ndotësit e ujërave, për emisionet e dëmshme dhe ndikimi i tyre mbi ujërat dhe mbi mjedisin jetësor në përgjithësi ka për qëllim të mundëson efektivitet dhe objektivitet të masave të sjellura drejtuese dhe ekonomike. Shqyrtimi i të dhënave jep mundësi organi ti proekton ndikimet e dëmshme të mundshme dhe implikacionet e tyre në lidhje me kualitetin e ujërave dhe jetën dhe shëndetin e njerëzve. Publiku ka të drejtë të jetë në dijeni se kush, në çfarë sasie dhe në çfarë mënyrë ndotë mjedisin në të cilin jeton dhe punon, dhe ka të drejtë të merr pjesë në sjelljen e vendimeve që e tangojnë.

Evidencë jo e kompletuar dhe e paazhuruar

Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor (MMJPH) nuk korespondon me të dhëna komplete për atë se kush dhe me çka dhe në çfarë sasie i ndotë dhe i shfrytëzon ujërat në Maqedoni. Evidenca e saktë do ta mundëson organin kompetent të ketë kontrollë të presioneve mbi ujërat, ta përcakton prejardhjen e ndotjes dhe të vlerëson se a bëhet ngarkimi mbi resursin në bazë dhe në pajtim me licencë, të vlerëson se a ka dhe në çfarë sasi zbatohen parimet që shfrytëzuesi dhe ndotësi të paguan dhe në mënyrë konsekuente do ti mundëson që masat drejtuese ti proekton në pajtim dhe si përgjigje e ndotjes.

MMJPH, nëpërmjet Sektorit për ujëra në Drejtorin për mjedis jetësor, i evidenton gjithë kërkesat dhe licencat e dhëna në të ashtuquajturin libër ujor, si bazë e të dhënave për shfrytëzimin e ujërave. Në esencë, ajo duhet të paraqet një regjistër të kompletuar dhe të azhuruar të licencave të dhëna dhe të dhëna tjera të rëndësishme për vendimet menaxhuese në lidhje me ujërat. Me ndryshimet e Ligjit për ujëra, libri ujor është transformuar në sistem informativ për ujëra,i cili përpos informatave paraprake do të përmban dhe të dhëna nga sistemi informativ gjeografik, do të thotë të dhëna për koordinata dhe paraqitje kartografike për presionet mbi resursin. Në praksë, evidenca mbahet vetëm për licenca që janë dhënë- për mbajtjen dhe më rallë për lëshimet e ujërave të zeza- dhe ajo nuk azhurohet regullisht. Me këtë, organi ka evidencë për atë se kush ka licencë, por jo kush duhet të ketë dhe kush ska. Ka evidencë kush përdor, por jo dhe ku lëshon ujin dhe materiet e dëmshme pas shfrytëzimit. Në këtë mënyrë, evidenca për presionin nuk jep fotografi reale për gjendjen me resursin ujor, kvalitetit të tij, dhe mund të sjellë deri te dhënia e licencës aty ku faktikisht nuk duhet të jepet. Kjo gjendje e evidencës të pakompletuar dhe të paazhuruar pjesërisht është si rezultatei mosegzistimit të një akti nënligjor me të cilin do të drejtohet mënyra e vendosjes dhe azhurimit të sistemit informativ për ujëra, për të cilin bazë ligjore është paraparë në Ligjin për ujëra.

Nuk ka katastër të ndotësve dhe ujërat e zeza industriale lëshohen të papastruara

Më tej, për përcaktimin e burimit dhe nivelit të ndotjes, Ligji për ujëra parasheh vendosje të katastrit të

ndotësve të ujit. Katastri duhet të përmban të dhëna për aktivitetet dhe objektet të cilat paraqesin ose mund të paraqesin rrezik për mjedisin jetësor dhe mediumeve të posaçme, duke i përfshirë dhe vendet industriale dhe ndërrmarjet komunale publike. Në praktikë, nuk egziston akt nënligjor me të cilin përshkruhet mënyra e vendosjes dhe udhëheqjes të katastrit. Të dhënat për ndotjen e cila e ka prejardhjen nga operatorët e stacioneve industriale mbledhen nëpërmjet pyetësorëve, dhe nga tetëdhjetë ndërrmarje publike komunale, të dhëna për sasinë e ujërave të lëshuara dhe parametrat për ndotje janë marrë vetëm nga tre (Shkup, Berovë dhe Makedonski Brod). Për shkak të kësaj , nuk ka informatë të saktë dhe relevante për burimin e ndotjes, për parametrat dhe për nivelin e ndotjes të recipientëve me ujëra të zeza industriale dhe komunale.

Të dhënat zyrtare të Entit shtetëror për statistikë që mblidhen me një metodologji ndryshe dhe për tjetër përdorim, tregojnë se ujërat e zeza që lëshohen nga industria dhe minierat nuk kanë asnjë trajtim para se të lëshohen në truallin, kanalizimin, rrjedhat ujore, akumulacionet ose liqenet. Në vitin 2017, nga ujërat e zeza të përgjithshme të papastruara të lëshuara nga industria dhe minierat, 0.3% janë lëshuar në kanalizime, dhe 99.7 përqind në rrjedha ujore. Edhe ndërrmarjet publike komunale lëshojnë ujëra të papastruara nga kanalizimi në rrjedhë natyrore. Përveç në kanalizim (urban ose komunal), në sistemin e kanalizimit NPK pranojnë dhe ujëra industriale të papastruara të cilat industria i lëshon në kanalizim. Ashtu që, në lidhje me nivelin e ndotjes, edhe ujërat nga NPK që lëshohen të papastruara përmbajnë materie ndotëse si ato industriale.

Me Ligjin për ujëra vendoset detyrim për monitorim të mbrendshëm të operatorëve të instalacioneve në pajtim me licencat e integruara ekologjike(licencat ujore). Gjithashtu, ndërrmarjet komunale publike janë të detyruara të bëjnë monitorim të mbrendshëm të ujërave të zëna dhe lëshimeve dhe të dhënat ti dërgojnë deri tek organi i cili do ti evidenton në sistemin informativ. Këto të dhëna janë të dhëna hyrëse për udhëheqje të Katastrit të ndotësve. Ky detyrim nuk aplikohet në praktikë.

Evidenca parciale e këtij lloji dhe mbajtja e saj në bazë vullnetare nuk jep shqyrtim të përgjithshëm të ngarkesës mbi çdo trup ujor në teritor të shtetit, dhe të dhënat të fituara në bazë të kësaj nuk janë të mjaftueshme dhe nuk mund të përpunohen dhe të analizohen që të sillen masat adekuate. Ato nuk mund as të prezentohen në mënyrë të duhur dhe nuk janë në dispozicion për publikun e as publiku mund të kyqet në procesine sjelljes të vendimeve.

Katastri nuk është në dispozicion për publikun

Të dhënat nga Katastri janë të dhëna të cilat duhet të jenë në dispozicion për publikun. Qasja e publikut deri te të dhënat (formë, sasi dhe mënyrë) përcaktohet me Ligjin për mjedis jetësor. Mënyra dhe forma në të cilën udhëheqet Katastri nuk mundëson kërkim adekuat të dhënash, prezentim dhe qasje deri te to, as dispozicion deri te publiku. Në praktikë, mungesa e të dhënave komplete në Katastër dhe mungesa e regullës për formën dhe mënyrën e mbajtjes dhe përmbledhjes të të dhënave nuk është në pajtim me ligjet. Katastri nuk është në dispozicion për publikùn, dhe MMJPH gjen të dhëna relevante dhe informata për publikun vetëm në bazë të kërkesave individuale dhe në pajtim me Ligjin për qasje të lirë në informata.

Edhe ndërrmarjet komunale publike lëshojnë ujëra të zeza pa licencë

Problemi e evidencës joadekuate në sferën e ujërave direkt rezulton me praktikën që subjektet aspak mos të aplikojnë për licencë(për shfrytëzim dhe lëshim në ujëra), edhe pse, sipas Ligjit, atë është dashur ta bëjnë në afat të caktuar. Gjithashtu, është evidente dhe praktika e vendosur nga ana e shtetit që ti toleron dhe mos ti sanksionon subjektet që shfrytëzojnë dhe lëshojnë ujëra të zeza pa licencë dhe jodënueshmëria e lëshimeve të dëmshme pa pastrim, dhe për atë arsye çdokush mund të lëshon materie të dëmshme dhe të rrezikshme pa poseduar licencë, të ndotë dhe gjatë kësaj mos të paguan për reparacion të resursit ose ti nënshtrohet sanksionit për veprimin antiligjor. Sa për ilustrim, në 12 komuna, ndërrmarjet publike nuk kanë siguruar licencë për shfrytëzim të ujit, ndërsa 8 ndërrmarje aspak nuk kanë aplikuar për kërkesë të licencës.



Nga gjithsej 36 ndërrmarje publike që kryejnë shërbime për mbledhje dhe largim dhe/ose pastrim të ujërave të zeza, licencë për lëshim kanë vetëm katër ndërrmarje publike nga Strumica, Berova Makedonski Brod dhe Koçani. Sigurisht, mungesa e licencës nuk i ndalon komunat dhe ndërrmarjet e tyre publike ta fakturojnë shërbimin për ujin që në mënyrë joligjore e shfrytëzojnë dhe e distribuojnë, gjegjësisht në mënyrë joligjore kryejnë lëshim dhe e ndotin mjedisin jetësor. Edhe më apsurde është situata në të cilën qytetarët të rajoneve të komunave që posedojnë licencë dhe stacione për pastrim paguajnë llogari më të larta për shërbime ujore në krahasim me ato të cilët aspak nuk posedojnë licencë. Kjo është në kundërshtim me parimin për kthim total të harxhimeve, gjegjësisht se ndotësi/shfrytëzuesi paguan, si parim bazik i përcaktuar me Ligjin për ujëra.

Tejkalim i situatës

Krijimi i një baze gjithpërfshirëse, të saktë dhe relevante e të dhënave për libër ujor dhe katastër të ndotësve të ujit është hap i parë kah tejkalimi i këtyre situatave apsurde. Përputhja e të dhënave në sistemin informativ do të jep shqyrtim në praktikat joligjore dhe mundësi për sanksionimin e tyre, do të mundëson qëndrueshmëri në menaxhimin me resurset ujore dhe transparencë në proces,për shkak të kësaj, Buxheti për krijimin e bazës të saktë relevante dhe gjithpërfshirëse të të dhënave vlerësohet të jetë 381.750 euro, që duhet ti mbulon pjesët për mbledhjen e të dhënave për ndotës të ujit dhe për përpunim të zgjidhjes softuerike për sistem informativ/ katastër të ndotësve dhe mirëmbajtje e regullt të tij.

Burime të konsultuara

- Pulevska B.,Popovski N. (2020). Probleme në menaxhimin me resurset ujore : Si ta shfrytëzojmë dhe ta mbrojmë ujin. Instituti për studime komunikative, Shkup.
- Enti shtetëror për revizion (2019). Raport final për revizion të kryer të suksesshmërisë „Efektivitet nga politikat, masat dhe aktivitetet gjatë dhënies të drejtës ujore“.
- Enti shtetëror për statistikë (2019). Statistika për mjedis jetësor 2019.



Më tepër në temën të kësaj rezyme është shpjeguar në dokumentin për politikë publike

„Problemet Në Menaxhimin Me Resurset Ujore: Si Ta Shfrytëzojmë Dhe Ta Mbrojmë Ujin“.

Институт за комуникациски студии
02 30 90 004 info@iks.edu.mk www.iks.edu.mk

British Embassy Skopje
UKaid from the British people

Ky produkt është pregaditur në suaza të proektit “Bashko pikat: Politika të përmirsuara nëpërmjet pjesëmarjes qytetare“, i financuar nga Qeveria e Mbretërisë të Bashkuar, me përkrahje të ambasadës Britanike në Shkup. Mendimet dhe qëndrimet të përmendura në këtë përmbajtje nuk i reflektojnë çdoherë mendimet dhe qëndrimet e Qeverisë britaneze.